



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

Nr. _____ Prot

Date, ____/____/2026

PROJEKT - V E N D I M

Nr. _____ / Date ____/____/ 2026

**“ PËR MIRATIMIN E SISTEMEVE TE PIKEZIMIT PER PROGRAMET
SOCIALE TE STREHIMIT ”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të Ligjit Nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”, nenit 15, pika 3, të Ligjit Nr. 22/2018, “ Për Strehimin Social ”, të nenit 12 pika “ a” te Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, të VKM-së nr. 361 datë 29.05.2019 “Përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj, dhe të bashkëpunimit institucional”, VKM nr. 362 datë 29.05.2019 “ Kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, Vendimit nr. 453 datë 03.07.2019 “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”

TË VENDOSË

1. Miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet sociale të strehimit , pranë Bashkisë Kavajë si më poshtë:
 - a) Sistemi i pikëzimit për programin e banesave sociale me qera / subvencionimi i qerave ne treg te lire (Aneksi 1)
 - b) Sistemi i pikëzimit për programin e banesave me kosto te ulët / subvencionimi i interesave te kredise . (Aneksi 2)

Ankesi 1

SISTEMI I PIKËZIMIT PËR PROGRAMIN E BANESAVE SOCIALE ME QIRA/SUBVENCIONIMI I QIRASË NË TREG TË LIRË		
Nr.	KRITERET E PIKËZIMIT	
A	KUSHTET E STREHIMIT	PIKËT
		25

i	Nuk disponon banesë në pronësi	17
ii	Banesa në rrezik shembje	6
iii	Banojnë në banesa të mbi populluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi;	4
iv	Kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore;	3
v	Familje ose individë që humbasin banesën e tyre si pasojë e zhvendosjes ose e zbatimit të një vendimi gjyqësor	2
vi	Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike;	3
B	KUSHTET FAMILJARE	25
i	Familje një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë; ku përfshihen dhe vajzat nëna;	8
ii	Të moshuarit që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk për zgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;	4
iii	Familjet me më shumë se katër fëmijë;	6
iv	Familjet e reja, ku mosha e anëtarit më të madh të familjes në momentin e kërkesës të jetë më e vogël ose baraz me 40 vjeç.	4
v	Të rinj që në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë një moshë jo më të madhe se 40 vjeç.	3
C	KUSHTET SOCIALE	25
i	Personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave;	3
ii	Individë me statusin e jetimit që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesit shoqëror e deri në moshën 30 vjeç;	3
iii	Familje e mbetur e pastrehë për shkak të lirit të banesave të ish-pronarëve.	1
iv	Emigrantë I rikthyer, punëtorë emigrantë dhe azilkërkuesit, refugjatë apo personat me mbrojtje plotësuese;	3
v	Familjet e policëve të rënë në detyrë.	3

Anksi 2

SISTEMI I PIKËZIMIT PËR PROGRAMIN E BANESAVE ME KOSTO TË ULËT/SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TE KREDISË		
Nr.	KRITERET E PIKËZIMIT	PIKËT
A	KUSHTET E STREHIMIT	
i	Nuk disponon banesë në pronësi	25
		7

ii	Banesa në rrezik shembje	4
iii	Banojnë në banesa të mbi populluara, sipas përcaktimeve dhe normave nëfuqi;	4
iv	Kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastrehë, si rezultat i Fatkeqësive natyrore;	4
v	Familje ose individë që humbasin banesën e tyre si pasojë e zhvendosjes ose e zbatimit të një vendimi gjyqësor	3
vi	Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike;	3
B	KUSHTET FAMILJARE	25
i	Familje një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë; ku përfshihen dhe vajzat nëna;	5
ii	Të moshuarit që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;	0
iii	Familjet me më shumë se katër fëmijë;	6
iv	Familjet e reja, ku mosha e anëtarit më të madh të familjes në momentin e kërkesës të jetë më e vogël ose baraz me 40 vjeç.	7
v	Të rinj që në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë një moshë jo më të madhe se 40 vjeç.	7
C	KUSHTET SOCIALE	25
i	Personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave;	3
ii	Individë me statusin e jetimit që nga çasti I daljes nga qendrat e përkujdesit shoqëror e deri në moshën 30 vjeç;	3
iii	Familje e mbetur e pastrehë për shkak të lirimit të banesave të ish-pronarëve.	0
iv	Emigrantë I rikthyer, punëtorë emigrantë dhe azilkërkuesit, refugjatë apo personat me mbrojtje plotësuese;	3
v	Familjet e policëve të rënë në detyrë.	0

- Komisioni i Strehimit do të marrë në shqyrtim të gjitha kërkesat e aplikuesve për strehim sipas programeve përkatëse të percaktuar me ligj, **referuar sistemit të pikezimit.**
- Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr.03 dt, 23.01/2013 “ Për miratimin e sistemit të pikëzimit për pragramin e banesave sociale për strehim “ revokohet .
- Të ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi Komisioni i Strehimit , Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Strehimit, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ,
- Ky Vendim hyne në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6.neni 55, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit nga institucioni i Prefektit të Qarkut,Tirane.



Drejtoria e Mrojtjes së Konsumatorit dhe Strehimit
Izmir Hoxha

Drejtoria Ligjore
Helidon Plaku

Drejtoria e Burimeve Ekonomike
Albi Lushka

Sekretar i Keshillit Bashkiak
Meri Biturku



[Handwritten signature]

RELACION

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të Ligjit Nr. 115/2014 "Për ndarjen administrative territoriale të njësisë të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë", nenit 15, pika 3 të Ligjit Nr. 22/2018, "Për Strehimin Social", të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 384, datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", të VKM-së nr. 361 datë 29.05.2019 "Përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj, dhe të bashkëpunimit institucional", VKM nr. 362 datë 29.05.2019 "Kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij", Vendimit nr. 453 datë 03.07.2019 "Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti" i kerkohet Këshillit bashkiak të miratojë sistemeve të pikezimit për programet sociale të strehimit, pranë Bashkisë Kavajë si më poshtë:

- a) Sistemi i pikëzimit për programin e banesave sociale me qera / subvencionimi i qerave në treg të lire **(Aneksi 1) bashkengjitur projek-vendimit.**
- b) Sistemi i pikëzimit për programin e banesave me kosto të ulët / subvencionimi i interesave të kredise . **(Aneksi 2) bashkengjitur projek-vendimit.**

Komisioni i Strehimit shqyrton dhe merr vendime në lidhje me kërkesat e paraqitura nga çdo subjekt që kërkon për të përfituar nga njeri prej programeve sociale të strehimit, si dhe për çdo çështje tjetër që parashikohet nga legjislacioni për strehimin, ceshtjet sociale apo nga akte të tjera ligjore dhe nenligjore në fuqi, që përcaktojnë shqyrtimin e kërkesave nga ky komision.

Komisioni i Strehimit asistohet nga një sekretariat administrativ, i cili asiston komisionin gjatë gjithë veprimtarisë së tij. Anëtarët e sekretariatit janë pjesë e Drejtorisë së Strehimit dhe të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale dhe janë përgjegjëse për;

- a) Marrjen në dorëzim të aplikimeve dhe kërkesave që janë objekt i shqyrtimit dhe vendimarrjes së Komisionit.
- b) Shpërndan dhe vë në dispozicion të anëtareve të komisionit, materialet për mbledhjen e rradhës.
- c) Mban, harton dhe nënshkruan procesverbalin e mbledhjes.
- ç) Zbardh vendimin e arsyetuar të marrë në mbledhjen e Komisionit i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët prezent.
- d) Ruan konfidencialitetin.


Ligji nr. 22/2018, "Për strehimin social", ka për objekt të tij administrimin dhe shpërndarjen së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim, si dhe referuar **nenit 15, pika 5** të po këtij ligji, përcaktohet se lista e përfituesve dhe dokumentacioni përkatës për përftimin nga programi i bonusit të strehimit **vlerësohet nga komisioni i strehimit dhe miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.**

Komisioni i Strehimit do të marrë në shqyrtim të gjitha kërkesat e aplikuesve për strehim sipas programeve perkatese të percaktuar me ligj, **referuar sistemit të pikezimit.**
Miratimi i sitemit të pikezimit është një detyrim ligjor pas hyrjes në fuqi të ligjit Nr.22/2018 " Per strehimin Social ", i ndryshuar .
Neni 15 pika 2) e ligjit Nr.22/2018 " Per strehimin Social ", i ndryshuar , parashikon se perzgjedhja e subjekteve perfitues me ane të një sistemi të pikezimit perfshien individe/familje të cilet permbushin nivelin e të ardhurave të parashikuar sipas cdo programi strehimi.

Sistemi i pikezimit në total duhet të permbaje 100 pike , ku cdo kriter i percaktuar në nenin 16 të ligjit Nr.22/2018 " Per strehimin Social" , permban 25 pike.Menyrë e shperndarjes së pikeve në perputhje me kriteret e percaktuara , miratohet nga njesia e vetqeverisjes vendore me vendim të keshillit të njesise se vetqeverisjes vendore , i cili shpallet publikisht sipas ligjit per vetqeverisjen vendore .

Të ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi Komisioni i Strehimit , Drejtoria e Mrojtjes së Konsumatorit dhe Strehimit, Drejtorisa e Shërbimeve Sociale .

Konc.Pergj.Sek.Strehimit
Eni Xoxe



Drejtoria e Mrojtjes se Konsumatorit dhe Strehimit

Izmir Hoxha

